

## Vendim nr. 164 datë 16.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 16.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (V) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** VASILLAQ MASATI, MAKSIM MEBELLI, AGRON NUSHI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 62-2016-3141 (537), datë 01.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 466, datë 26.07.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2023-1807, datë 07.11.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 18, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134 shkronja “i” i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 deri 30, 39, 42 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Shtetasit Vasillaq Masati, Maksim Mebelli dhe Agron Nushi (*kërkuesit*) së bashku me shtetasin V.F., janë proceduar penalisht për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 186, pika 2, i Kodit Penal (KP).

2. Më konkretisht, ka rezultuar se kërkuesit Vasillaq Masati dhe Maksim Mebelli, në cilësinë e anëtarëve të Sindikatës Autonome të Nxjerrësve të Naftës Patos (SANN), dhe Agron Nushi, në cilësinë e sekretarit të përgjithshëm të SANN-së, janë akuzuar se në bashkëpunim me njëri-tjetrin, me qëllim zëvendësimin e kryetarit të SANN-së, shtetasin M.G., kanë depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dokumentacionin për zëvendësimin e tij. Mbi bazën e këtij dokumentacioni, ajo gjykatë, me vendimin nr. 6951, datë 20.06.2013, ka vendosur zëvendësimin e kryetarit të SANN-së. Për rrjedhojë, shtetasi M.G. ka paraqitur kallëzim ndaj këtyre shtetasve për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, pika 2, i KP-së. Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, pasi ka kryer veprimet hetimore, ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të kërkuesve dhe shtetasit V.F.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2016-3141 (537), datë 01.07.2016, ka gjykuar çështjen me ritin e gjykimit të shkurtuar dhe ka vendosur të deklarojë fajtorë të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 186, pika 2, i KP-së, duke i dënua ata me 2 vjet burgim, si dhe deklarimin e falsitetit të vendimeve të Kongresit të SANN-së, Patos. Në vendimin e saj, ndër të tjera, ajo gjykatë ka arsyetuar se nga analiza e fakteve dhe rrethanave ka rezultuar e provuar se kërkuesit në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë falsifikuar dokumentacionin që i përket Kongresit të 4-t të SANN-së, Patos. Po sipas gjykatës, veprimet e të pandehurve kanë pasur si qëllim ndryshimin e kryetarit të SANN-së, Patos dhe bashkimin e saj me Federatën e Sindikatave të Pavarura të Bashkuara të Shqipërisë (SPBSH), me qëllim që kjo e fundit të merrte pronësinë e Kampit të Punëtorëve Vlorë, fakt që është vërtetuar nga kontrata e kalimit të pronësisë së kësaj pasurie për llogari të SPBSH-së, si dhe nga certifikata e regjistrimit të pasurisë në favor të kësaj të fundit. Kundër këtij vendimi kërkuesit kanë paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 466, datë 26.07.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke vlerësuar se ka rezultuar e provuar se të pandehurit, në mënyrë të paligjshme dhe në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë falsifikuar

dokumentacionin në fjalë, për rrjedhojë edhe vendimmarrjet e këtij kongresi. Në lidhje me ekzekutimin e vendimit me burgim ndaj kërkuesve, bazuar në nenin 59 të KP-së, gjykata e apelit ka vendosur pezullimin e tij, duke i vendosur ata në provë për një periudhë kohore 3-vjeçare. Kundër këtij vendimi kërkuesit kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2023-1807, datë 07.11.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk ishin ngritur shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

6. Në datën 16.05.2024 kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 03.06.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesve

7. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se iu është cenuar:

7.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

7.1.1. *Parimit të gjykatës së paanshme*, pasi gjykimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier është realizuar në kushte njëanshmërie ku gjykata ka mbajtur rolin e organit të akuzës.

7.1.2. *Parimit të sigurisë juridike dhe atij ne bis in idem*, pasi çështja e kërkuesve është hetuar njëherë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është pushuar dhe në këtë mënyrë ajo konsiderohet “*gjë e gjykuar*”. Ky vendim i pushimit të procedimit penal është ankimuar dhe lënë në fuqi nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Pretendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili është mbështetur edhe nga Gjykata e Lartë, se vendimet e pushimit duhej të paraqiteshin si provë nga të pandehurit, nuk qëndrojnë, pasi këto vendime janë përmendur nga palët si gjatë hetimit, ashtu edhe gjatë gjykimit dhe gjykata ka pasur detyrimin ligjor për administrimin e tyre. Gjithashtu, aktet e pretenduara si të falsifikuara kanë qenë objekt shqyrtimi gjyqësor në gjykatat civile të cilat me vendimet e tyre i kanë konfirmuar ato.

7.1.3. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat e kanë zhvilluar gjykimin me bindjen se të pandehurit e kanë kryer krimin për të cilin akuzohen, edhe pse

barrën e provës e ka organi i akuzës. Të vetmet prova mbi të cilat është mbështetur vendimi i fajësisë janë deklaratimet e kallëzuesit.

7.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë duhej të merrte në shqyrtim faktin se i njëjti procedim penal me të njëjtat prova është hetuar dhe pushuar më parë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkesve

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik subjekt i së drejtës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Si bartës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

11. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i

Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 07.11.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 16.05.2024. Sipas informacionit zyrtar të vënë në dispozicion nga Gjykata e Lartë, vendimi i kësaj gjykate është bërë i disponueshëm për palët në datën 18.01.2024, për rrjedhojë kërkesa konsiderohet e paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

12. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *cenimit të parimeve të gjykatës së paanshme, të sigurisë juridike dhe ne bis in idem* dhe të *prezumimit të pafajësisë*, si dhe cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*. Për sa u përket pretendimeve në lidhje me *cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, Kolegji vëren se pretendimet e kërkesve janë formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe ato mbështeten në faktin se gjykatat e faktit kanë pranuar cilësimin e veprës penale të organit të akuzës dhe dënimin që u atribuohet atyre. Kërkesit nuk kanë arritur të parashtrajnë fakte për të provuar se cilat janë ato sjellje ose veprime të gjyqtarëve/gjykatës që në aspektin subjektiv ose objektiv vënë në dyshim respektimin e këtij parimi gjatë gjykimit të çështjes së tij.

13. Për sa u përket pretendimeve të kërkesve për *cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë*, Kolegji vëren se sipas këtij parimi, të garantuar në nenin 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe ai kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar se ajo mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, por jo për mënyrën e vlerësimit (*shih vendimet nr. 37, datë 19.09.2011; nr. 45, datë 10.10.2010; nr. 23, datë 17.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit, janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe se ato mund të merren në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore, duke bërë vlerësim të natyrës kushtetuese të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022; nr.7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në kuptim të këtyre standardeve, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesve në drejtim të këtij parimi janë me natyrë ligjore dhe kanë të bëjnë më çështje të vlerësimit të provave dhe zbatimit të ligjit, të cilat, si rregull, janë atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues. Kërkuesit nuk kanë arritur të argumentojnë se si vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt në këtë aspekt, duke mos arritur të argumentojnë pretendimin e tyre në aspektin kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesve, për *cenimin e parimit të sigurisë juridike* dhe *ne bis in idem*, si dhe *parimit të barazisë përpara ligjit*, Kolegji vlerëson se në thelb ato kanë të bëjnë me respektimin nga gjykatat e zakonshme të parimit *ne bis in idem*, për shkak se çështja e tyre është hetuar më parë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur pushimin e procedimit penal, vendim i cili edhe pas ankimimit, është lënë në fuqi nga gjykatat e zakonshme. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji vlerëson se ai është me natyrë kushtetuese dhe çmon ta analizojë në vijim të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

*B. Për pretendimin e cenimit të parimit ne bis in idem të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*

16. Kërkuesit kanë pretenduar se çështja e tyre është hetuar njëherë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është pushuar, çka e bën atë “*gjë të gjykuar*”. Vendimi i pushimit të procedimit penal është lënë në fuqi me vendimin nr. 1297, datë 10.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimin nr. 1056, datë 10.07.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas kërkuesve, pretendimi i gjykatës së apelit se vendimet e pushimit duhet të paraqiteshin si provë nga të pandehurit nuk qëndron, pasi këto vendime janë përmendur nga palët si gjatë hetimit, ashtu edhe gjatë gjyqimit dhe gjykata ka pasur detyrimin ligjor për administrimin e tyre. Po sipas kërkuesve, aktet e pretenduara si të falsifikuara kanë qenë objekt shqyrtimi gjyqësor në gjykatat civile, të cilat, me vendimet e tyre, i kanë konfirmuar ato.

17. Sipas nenit 34 të Kushtetutës, askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se sipas këtij parimi askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një veprë penale, për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar. Ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron te zbatimi dy a më shumë herë i së njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtin fakt që përbën veprë penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kriteri “e njëjta veprë” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, veprë penale dhe kualifikim ligjor që formojnë bazën e kësaj veprë dhe për të cilën personi është dënuar ose liruar. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm (shih vendimet nr. 8, datë 28.02.2012; nr. 33, datë 22.07.2011; nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi *ne bis in idem* nuk gjen zbatim në rastet kur i njëjti veprim përbën cenim të dy dispozitave të ndryshme ligjore (shih vendimin nr. 5, datë 08.03.2005 të Gjykatës Kushtetuese) dhe as kur veprat penale nuk kanë elemente të njëjta. Në këtë kuptim, një person i gjykuar dhe i dënuar me vendim të formës së prerë nuk mund të procedohet dhe të gjykohet përsëri për të njëjtën akuzë, që duhet kuptuar për të njëjtin fakt. Për pasojë, një fakt i ri do të gjykohet normalisht edhe pse është kryer nga i njëjti person dhe ka të njëjtin cilësim ligjor me një fakt tjetër për të cilin ai është dënuar më parë. Po sipas Gjykatës, vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes penale nuk përfaqëson një vendim përfundimtar, të formës së prerë, të dhënë nga një gjykatë e caktuar me ligj, në këtë kuptim, nuk ka cenim të parimit *ne bis in idem* (shih vendimin nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

19. Në lidhje me standardin e arsytimit, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale ose civile, si një garanci për procesin ligjor. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme ajo ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 8, datë 28.02.2012; nr. 8, datë 16.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji vëren se procedimi penal mbi bazën e të cilit janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë, është vënë në lëvizje mbi bazën e kallëzimit të shtetasit M.G., ish-kryetar i sindikatës SANN-së, Patos, për falsifikimin dokumentacionit të Kongresit të 4-t të kësaj sindikate. Ky procedim është regjistruar nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me nr. 616, datë 25.09.2013, ndërsa në datën 02.02.2015, prokuroria ka përcjellë çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila, në përfundim të gjykimit, ka vendosur deklarin fajtor të kërkuesve dhe dënimin e tyre me 2 vjet burgim, me arsyetimin se në bashkëpunim me njëri-tjetrin, ata kishin përpiluar dokumentacionin për organizimin e kongresit të 4-t të SANN-së, Patos, duke pasqyruar në të të dhëna të pavërteta. Ky vendim është vlerësuar i drejtë nga gjykata e apelit, e cila në vijim ka pezulluar ekzekutimin e dënimit të caktuar nga gjykata e rrethit, duke i vënë kërkuesit në periudhë prove për 3 vjet. Për sa u përket pretendimeve se ndodheshin në kushtet e gjësë së gjykuar, gjykata e apelit ka vlerësuar se mbrojtja e kërkuesve u referohej akteve të cilat nuk i ishin nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit në seancë gjyqësore, dhe se, pavarësisht pretendimeve të M.M. për ekzistencën e tre vendimeve të tjera, asnjëri prej kërkuesve nuk kishte paraqitur kopje të këtyre vendimeve. Nga ana tjetër, sipas gjykatës, vendimet e pretenduara bënin fjalë për gjykime civile dhe jo penale (*shih faqen 21 të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë*).

21. Ligjshmëria e vendimeve të gjykatave të faktit i është nënshtruar më pas kontrollit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë bazuar në rekursin e paraqitura nga kërkuesit, në përfundim të shqyrtimit të të cilave është vendosur mospranimi i tyre me arsyetimin se gjykata e apelit u kishte dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të kërkuesve si në drejtim të çmuarjes së provave, ashtu edhe në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, provueshmërisë së fajësisë për kryerjen e veprës penale për të cilën ata ishin akuzuar. Po sipas Kolegjit Penal, Gjykata e Lartë është gjykatë ligji, së cilës palët mund t'i drejtohen vetëm për shkaqet e përcaktuara në nenin 432 të KPP-së, ndaj, në këtë kuptim, kërkuesit nuk kishin arritur të argumentonin cenimin e ligjit penal material ose procedural nga gjykata e apelit, vendimmarrja e kësaj gjykate nuk rezultonte në mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore me pasojë pavlefshmërinë absolute të akteve, papërdorshmërinë e provave ose që vendimi vinte ndesh me



praktikën e Kolegjit Penal ose Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih faqen 14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

22. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme, Kolegji vëren se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fierit ka nisur procedimin penal nr. 616/2013, ndaj kërkuesve për kryerjen e veprës penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, për të cilin gjykatat e zakonshme kanë disponuar përfundimisht me dënimin e kërkuesve me 2 vjet burg, pezullimin e zbatimit të tij dhe vendosjen e tyre në periudhë prove për 3 vjet. Ndërkohë, rreth 2 vjet më pas regjistrimit të këtij procedimi penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka nisur procedimin penal nr. 25/2015 ndaj M.M. për kryerjen e veprës penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, konkretisht të statutit të SPBSH-së, bazuar në kallëzimin e V.F., të dy në cilësinë e kërkuesve në çështjen objekt shqyrtimi në Gjykatë. Ky procedim është pushuar me vendim të formës së prerë. Në këtë këndvështrim, ndonëse bëhet fjalë për të njëjtën veprë penale, fakti penal për të cilin kërkuesit janë gjykuar dhe dënuar nga gjykatat, rezulton të jetë i ndryshëm nga ai për çështjen në të cilin është vendosur pushimi i procedimit penal ndaj M.M. Duke pasur parasysh edhe jurisprudencën kushtetuese, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit *ne bis in idem* janë haptazi të pabazuara, pasi, përveç arsytimit të mësipërm, vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes penale nuk përfaqëson një vendim përfundimtar, të formës së prerë, të dhënë nga një gjykatë e caktuar me ligj, në këtë kuptim, nuk ka cenim të parimit *ne bis in idem*.

23. Po kështu, edhe për sa i përket pretendimit të kërkuesve se aktet e prodhuara nga kongresi janë çmuar të vlefshme nga gjykatat civile, në këto kushtet ato janë të detyrueshme edhe për gjykimin penal konkret, Kolegji vlerëson se ato nuk kanë lidhje me gjykimin penal objekt shqyrtimi në Gjykatë, për rrjedhojë edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar.

24. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit *ne bis in idem* të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.